

**No. 26273**

---

**FRANCE  
and  
ALBANIA**

**Framework Agreement on economic, industrial and technical  
cooperation. Signed at Tirana on 17 February 1988**

*Authentic texts: French and Albanian.*

*Registered by France on 4 November 1988.*

---

**FRANCE  
et  
ALBANIE**

**Accord cadre de coopération économique, industrielle et  
technique. Signé à Tirana le 17 février 1988**

*Textes authentiques : français et albanais.*

*Enregistré par la France le 4 novembre 1988.*

## [ALBANIAN TEXT — TEXTE ALBANAIS]

MARREVESHJE KUADER PER BASHKEPUNIMIN EKONOMIK,  
INDUSTRIAL E TEKNIK NDERMJET QEVERISE SE REPUB-  
BLIKES FRANCEZE DHE QEVERISE SE REPUBLIKES PO-  
PULLORE SOCIALISTE TE SHQIPERISE

Qeveria e Republikes Franceze dhe Qeveria e Republikes Popullore Socialiste te Shqiperise, me poshte te quajtura "Pale", te nisura nga deshira per te zhvilluar marredheniet e tyre ekonomike mbi bazen e leverdise te nedersjellte, u moren vesh per sa vijon:

*Neni 1*

Palet te bindura ne interesin qe paraqet per secilen prej tyre rritja e shkembimeve ekonomike, do te favorizojne dhe do te perpiqen te japin te gjitha lehtesite e nevojshme per zhvillimin e bashkepunimit ekonomik, industrial dhe teknik, ndermjet ndermarrjeve, organizatave dhe institucioneve perkatese te dy vendeve ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne secilin vend.

*Neni 2*

Te dyja Palet i kushtojne nje rendesi te madhe informimit te tyre te ndersjellte per drejtimet e zhvillimit ekonomik dhe per fushat konkrete te bashkepunimit.

*Neni 3*

Te dyja Palet do te zhvillojne bashkepunimin ekonomik, industrial dhe teknik ne fushat e meposhtme:

- a) Industrine e minierave;
- b) Energjitiken;
- c) Bujqesine;
- d) Industrine e Lehte dhe Ushqimore;
- e) Industrine mekanike;
- f) Metalurgjine;
- g) Elektroniken;
- h) Kimine;
- i) Ndertimin;
- j) Aeronautiken;
- k) Transportin;

si dhe ne fusha te tjera me interes per te dyja Palet.

*Neni 4*

Te dyja Palet ne perputhje me kushtet, mundesite dhe legjislacionin ne fuqi ne secilin vend, do te perkrahin forma te ndryshme te bashkepunimit industrial e teknik.

Keto do te kene te bejne kryesisht me projekte ose vepra te reja, me zgjerimin e kapaciteteve te veprave ekzistuese, me pajisjet si dhe me lejet (licensat) e prodhimit.

*Neni 5*

Krijohet nje Komision i Perbashket nderqeveritar i bashkepunimit ekonomik, industrial e teknik, i ngarkuar te kujdeset per zhvillimin e marredhenieve ekonomike midis te dy vendeve.

Komisioni do te mblidhet, si rregull, nje here ne vit, me radhe ne Paris dhe ne Tirane.

Komisioni i Perbashket do te kete keto detyra kryesore:

- Diskutimin dhe zbatimin e Marreveshjes;
- Shqyrtimin e fushave konkrete te bashkepunimit;
- Rezultatet dhe perspektivat e bashkepunimit.

Komisioni i Perbashket u propozon autoriteteve kompetente çdo iniciative qe mendohet se i sherben forcimit te efikasitetit te veprimit te tij.

Palet do te merren vesh me njera tjetren ne rruge diplomatike per rendin e dites dhe per daten e mbledhjes.

*Neni 6*

Te dyja Palet duke iu referuar marreveshjes ne parim te arritur midis tyre ne shtator 1985 per krijimin e nje "Grupi studimi franko-shqiptar per zhvillimin e shkembimeve ekonomike" me perfaqesues te qarqeve afariste te te dy vendeve, nenvizojne interesin qe paraqesin veprimtarite e ketij grupi per zhvillimin e shkembimeve dhe te bashkepunimit ekonomik, industrial dhe teknik midis te dy vendeve dhe inkurajojne veprimin e tij.

*Neni 7*

Per zbatimin e kesaj Marreveshjeje, institucionet, organizatat dhe ndermarrjet e te dyja Paleve do te nenshkruajne midis tyre ne rast se do ta shohin te nevojshme marreveshje, protokolle, programe ose kontrata ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne secilin vend.

*Neni 8*

Kjo Marreveshje hyn ne fuqi ne daten e nenshkrimit te saj. Ajo eshte perfunduar per nje periudhe prej 5 vjetesh.

Pas mbarimit te kesaj periudhe, ajo do te zgjatet heshtazi per periudha te tjera nje vjeçare. Çdo kerkese per ribisedim, per pezullim ose per denoncim do te duhet t'i njoftohet Pales tjetere 6 muaj perpara dates se mbarimit te vlefshmerise se kesaj Marreveshjeje.

BERE ne Tirane, me 17 shkurt 1988, ne dy ekzemplare origjinale secili ne gjuhen franceze dhe shqipe, duke pasur te dy tekstet vlere te barabarte.

Per Qeverine  
e Republikes Franceze:

[*Signed — Signé*]

DIDIER BARIANI

Per Qeverine  
e Republikes Popullore Socialiste  
te Shqiperise

[*Signed — Signé*]

SOKRAT PLAKA